



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 400/10 prot.

Tiranë, më 31.07.2019

**VENDIM**

**Nr.89, datë 31.07.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 45, DATË 09.05.2019, NË**  
**QENDRËN E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE KORÇË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Nr. 45, datë 09.05.2019 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

**KONSTATOVA SE:**

Bazuar në Vendimin nr. 97, datë 03.12.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 45, datë 09.05.2019, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Në përfundim të afatit të lënë për zbatimin e këtij vendimi, Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 2068/2 prot., datë 24.06.2019, “Kthim përgjigje”,

ka informuar Komisionerin mbi masat e marra, duke bashkëngjitur edhe praktikën shkresore që materializon zbatimin e tij.

Mbështetur në gjetjet e specifikuara në këtë raport dhe në detyrat e lëna për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në pikën 2 të vendimit të Komisionerit, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike dhe eprorit direkt të rregullojnë situatën e paligjshmërisë në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, duke ndryshuar aktin për deklarimin e statusit të punësimit për këtë punonjës nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë prove*”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), kohëzgjatja e periudhës së punësimit të tij ishte më pak se 1 vit. Në vijim, është lënë detyrë që këtij punonjësi t’i krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 2068/2 prot., datë 24.06.2019, vërej se, me Vendimin nr. 46, datë 24.06.2019, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të vendimit paralajmërues Nr. 45, datë 09.05.2019, të Komisionerit, ka anuluar aktin e deklarimit nr. 3282/24 prot., datë 19.01.2015, duke e deklaruar punonjësin \*\*\*\*\* si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist pa grada/tituj shkencorë në Sektorin e Pemëve Farore*”, në Drejtorinë e Teknologjive Bujqësore, në QTTB Korçë.

Për sa u parashtrua më sipër, arrihet në përfundimin se nga ana e DAP, janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues Nr. 45, datë 09.05.2019, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 45, datë 09.05.2019, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë ”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse Departamenti i Administratës Publike duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 45, datë 09.05.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë, Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**